

## VEPRAT PENALE TE TË RINJTË

**DËMTIME TË TJERA ME DASHJE (PLAGOSJE E LEHTË/RËNDË NGA PAKUJDESIA)** - Objekt i mbrojtjes është shëndeti i njeriut, i mbrojtur posaçërisht nga legjislacioni penal. Kjo kundërvajtje kryhet me veprime aktive të kundërligjshme ose çdo vepër tjetër dhune, si p.sh. me goditje, me pëllëmbë, me grushta, shkelma, duke e rrëzuar në tokë me veprime që shkaktojnë dhimbje fizike dhe kryhet gjithmonë me dashje të drejtpërdrejtë. Kundravajtje të ngjashme të dënueshme janë edhe plagosja e lehte me dashje, plagosja e lehtë/ e rëndë nga pakujdesia)

Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ose që ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, është krim dhe dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

**PRODHIMI, MBAJTJA, BLERJA APO SHITJA PA LEJE E ARMËVE TË FTOHTA** - Prodhimi, mbajtja, blerja/shitja, e armëve të ftohta si thikë, dorezë metalike, përforcuese grushti, shpatë, bajonetë dhe e mjeteve të tjera të përgatitura e të destinuara për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Mbajtja, blerja /shitja në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, e armëve të ftohtasi më sipër, të përgatitura e të destinuara për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje, pa lejen e organeve kompetente, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet

**DHUNA NË FAMILJE** - Çdo vepër dhune në familje me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të anëtarëve të familjes përbën krim dhe dënohet vetëm me burgim dhe ndiqet nga prokuroria shqiptare edhe pa pëlqimin e personit të dëmtuar.

**KRIMET SEKSUALE** - Tek krimet me natyrë seksuale përgjithësisht objekt i këtij krimi janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë e papekshmërinë seksuale dhe zhvillimin seksual normal të personit të mitur, shëndetin dhe jetën e saj/tij, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale. Kjo sepse i dëmtuari/a nuk e ka arritur zhvillimin e përgjithshëm që të kuptojnë karakterin e veprës dhe të pasojave që mund të vijnë. Si objekte dytësore janë edhe nderi, dinjiteti, shëndeti e jeta e personit të dëmtuar.

## VEPRAT PENALE TE TË RINJTË

**PRODHIMI DHE SHITJA E NARKOTIKËVE** - Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Përdorimi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj, në një nga format e mësipërme, ka përgjegjësi penale.

**VJEDHJA** - Krimi i vjedhjes parashikohet në disa dispozita të Kodit Penal, duke marrë për bazë vendin, mjetin, si dhe mënyrën e kryerjes së krimit. Me vjedhje kuptohet marrja, hedhja në dorë, në mënyrë të kundërligjshme, të fshehtë ose të hapët, të pasurisë së luajtshme të dikujt tjetër, e kryer me dashje, me qëllim për të mos e kthyer më, për të nxjerrë përfitim material për vete ose në dobi të personave të tjerë.

**PËRNDJEKJA**- Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet.

**PËRDORIMI ME KEQDASHJE I THIRRJEVE TELEFONIKE** - Thirrjet telefonike keqdashëse që bëhen me qëllim për të prishur qetësinë e tjetrit, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

**DREJTIMI I AUTOMJETIT NË MËNYRË TË PARREGULLT** - Drejtimi i automjetit apo i mjeteve të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë e cila dënohet me burgim deri në 3 vjet. Dëshmia e aftësisë drejtuese të mjeteve përkatëse merret vetëm me arritjen e moshës 18 vjeç. Për drejtimin e motorëve është e nevojshme marrja e lejes së drejtimit të kategorisë A.



# Qendra Aura

## Të njohim Ligjin Penal



[auraforalbania@ngo-aura.al](mailto:auraforalbania@ngo-aura.al)  
<https://ngo-aura.al/>

# SHKOLLA DHE EDUKIMI LIGJOR I TË RINJVE

Edukimi i të rinjve me ligjin na mëson se njerëzit kanë liri, të drejta dhe përgjegjësi sipas ligjit. Përfshirja e paketave informuese dhe programeve rreth edukimit ligjor në shkollë është një masë që zbut sjelljet negative dhe luan rol në parandalimin e të miturve për tu përfshirë në krime. Ky proces ndikon në përballjen e të rinjve me sfidat e përditshme të lëndëve narkotike, presionit të bashkëmoshatarëve, krimit dhe dhunës.

Një rini e edukuar me ligjin përbën premisë për një shoqëri më të sigurt të së ardhmes me në qendër ligjin.

## PARIME TË DREJTËSISË PENALE PËR TË MITURIN:

- Jemi të ndryshëm por të barabartë përpara ligjit
- Mbrojtja e interesit më të lartë të të miturit
- Mosnjohja e ligjit nuk na shkarkon nga përgjegjësia penale
- Marrja e masa edukative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale.
- Mbrojtja e jetës private të të miturit
- E drejta për ndihmë ligjore dhe psikologjike për të miturin
- E drejta për tu ankuar në çdo fazë të procedimit

*Drejtësia duhet të jetë e fortë, por  
forca duhet të jetë e drejtë...*  
— Paskali

## DREJTESIA PENALE PËR TË MITURIN

Në vitin 2017 është miratuar një ligj i posaçëm, quhet Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (18-21 vjeç) i cili përmban rregullime të veçanta që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të të miturve, procedurën e hetimit, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër për të miturin. Sipas këtij kodi një i mitur mund të jetë viktimë, dëshmitar apo në konflikt me ligjin (p.sh. në ndjekje penale, i pandehur)

## QËLLIME

- Mbrojtja e të drejtave të të miturit në rastet kur është dëshmitar dhe/ose viktimë e veprës penale.
- Shqyrtimi i çështjeve pa vonesë dhe me përparësi për të miturin
- Caktimi i një vendimi të përshtatshëm për të korrigjuar sjelljen e të miturit
- Përparësia e masave alternative dhe kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit
- Garanci për rishoqërimin dhe rehabilitimin e të miturit që ka kryer vepër penale

## PËRGJEGJËSIA PENALE



Kodi Penal cakton dy kufinj të moshës për përgjegjësi penale.

- a) Për krimet personi duhet të ketë mbushur moshën 14 vjeç
- b) Për kundërvajtjet penale personi duhet të ketë mbushur moshën 16 vjeç

Ky dallim lidhet me nivelin e të kuptuarit dhe kontrolluarit të sjelljeve të personit. Një person në moshën 14 vjeç e ka arritur pjekurinë e mjaftueshme për të kuptuar se çfarë përbën krim. Nisur nga fakti se karakteri dhe rëndësia e kundërvajtjes penale nuk janë aq të kuptueshme sa krimi, arritja e moshës 16 vjeç bën që personi në këtë moshë të jetë në gjendje të kuptojë se po kryen kundërvajtje penale dhe të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij.

## Kundërvajtje penale

- Dëmtime të tjera me dashje
- Plagosja e lehtë me dashje
- Plagosja e rëndë nga pakujdesia
- Plagosja e lehtë nga pakujdesia
- Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike

## Krime

- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur
- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç
- Plagosja e rëndë me dashje
- Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta
- Dhuna në familje
- Dhuna seksuale
- Vepra të turpshme
- Ngacmimi seksual
- Përndjekja
- Keqtrajtimi i të miturit
- Vjedhja
- Prodhimi dhe shitja e narkotikëve
- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt

## DËNIMET KRYESORE

Dënimet kryesore, sipas parashikimit të nenit 29 të Kodit Penal janë me burgim të përjetshëm, me burgim, me gjobë. Sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në veçanti lloje e dënimeve :

Dënimet për të miturit janë dënimet jo me burgim dhe dënimi me burgim.

Në dënimet jo me burgim :

- a) kufizimi i lirisë;
- b) qëndrimi në shtëpi;
- c) gjoba;
- ç) kryerja e një pune me interes publik;
- d) ndalimi për kryerjen e një veprimtarie;
- dh) përmbushja e detyrimeve të caktuara.

Ndërgjegjësimi i të rinjve me njohjen e ligjit, shtrirjen e tij dhe sanksionet përkatëse është një metodë pozitive që njerëzit të sillen në harmoni me ligjet dhe rregullat juridike. Ligji penal është me rëndësi të veçantë për konsolidimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës. Respektimi dhe zbatimi i përpiktë i ligjit penal siguron dhënien e drejtësisë, rritjen e besimit të popullit ndaj pushtetit gjyqësor e sistemit të drejtësisë në tërësi.